



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR**  
**DREJTORIA EKONOMIKE**  
(Sektori i Financës)

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel. & fax. 00355 218 229 37

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 07 Datë 25/03/2024

**"Për alokim fondi ne buxhetin e vitit 2024"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.139 datë 29.12.2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.24/1 prot. datë 11.01.2024 :

**KËRKOJMË:**

- I. Ne pasqyren e investimeve per vitin 2024 kerkojme te behen ndryshime ne zerin Rikonstruksion shkolla "Selim Alliu"
- II. Te pakesohet zeri investime "Rikonstruksion i shkolles Selim Alliu ne vleren  
Te pakesohet 231-9120-05- 600.000  
Per vleresimin e nxenesve ekselente (11 nxenes \*50.000 leke=550.000)  
Per vleresimin e mesuesit te vitit ,Bashkia Diber viti 2023 -50.000  
Te shihet zeri 602 -9120-05- 600.000
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Drejtör Juridik  
Ismet Saraci

Drejtör Urbanistike  
Elvis Manga

Drejtör Ekonomik  
Çeljeta Zuna

**KRYETARI I BASHKISË**  
Rahim Spahiu

Nw murgesw dhe me porosi  
Zv.Kryetar  
Ruzhdi Deda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KRYETARI

Peshkopi, më 21/03 2024

**RELACION**

**Për vlerësimin e nxënësve ekselentë**

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak Dibër

**Të nderuar këshilltarë!**

Në zbatim të VKM-së Nr. 666, datë 10.10.2019.” *Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*” pika 2. “ *Nxënësit të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm professional në institucionet publike përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, pika 2.2 Kriteri i rezultateve të arritura: “Nxënësit të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare 9 ( nëntë) deri në 10 (dhjetë)”, Bashkia Dibër i propozon Këshillit Bashkiak miratimin nga ana juaj për mbështetjen e nxënësve të dalluar, si vlerësim dhe motivim për vazhdimësinë dhe përkushtimin e tyre në rrugën e dijes dhe të të nxënësve, duke shërbyer edhe si model për tu ndjekur nga bashkëmoshatarët e tyre.*

Emrat e nxënësve janë si më poshtë:

1. Bora Lleshi
2. Silvana Damzi
3. Irgesa Sadiku
4. Sara Uka
5. Ledion Alku

6. Sara Lleshi
7. Eva Lazimi
8. Selma Ademi
9. Oksana Bana
10. Elia Haliti
11. Sonela Krrashi
12. Kamela Xhediku

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, ju ftojme në miratimin e projekt aktit!

**Specialiste e Arsimit**


**Alma LLESHI**



**KRYETARI I BASHKISË**

**Rahim SPAHIU**

*Anton Zuar*  
*Ruzhdi Dede*  
*[Signature]*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
SEKTORI I ARSIMIT DHE KULTURËS

Peshkopi, më: \_\_.03.2024

**Relacion**

Mësuesi është një ndër figurat kryesore që luan një rol të pazëvendësueshëm në jetën e fëmijëve dhe të rinjve, sepse të jesh mësues është mision. Arsimitimi i gjeneratave të tëra të qytetarëve sjell zhvillim dhe ndryshim. Profesionin e mësuesit është një profesion human. Çdo prind i beson arsimin dhe edukimin e fëmijës së tij mësuesve

Çmimi Kombëtar “**Mësuesi i vitit**” i cili synon: “ Të evidentojë dhe vlerësojë në rang kombëtar mësuesit për kontributin që japin në mësimdhënie, që ndihmojnë fëmijët në mirëarsimimin e tyre, që përdorin teknika inovatore gjatë shpjegimit të lëndës së tyre, që mbrojnë dhe avokojnë për garantimin e një arsimit cilësor gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët në mbarë vendin”

Pas marrjes së titullit “**Mësuesi i Vitit**” akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për mësuesen **Adela Puca** nga shkolla 9- vjeçare “ Demir Gashi” Peshkopi,

Bashkia Dibër paraqet kërkesën për miratimin e shpërblimit nga ana juaj për këtë mësuese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në pritje të miratimit të projektaktit

Specialiste Arsimit

Alma LLESHI

KRYETARI I BASHKISË  
RAHIM SPAHIU

AUTORIZUAR

